

LIGJ
Nr.9789, datë 19.7.2007

**PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E ZONAVE TË TEKNOLOGJISË DHE
ZHVILLIMIT EKONOMIK¹**

(Ndryshuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

(I përditëuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon krijimin, funksionimin, mbikëqyrjen e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të drejtat dhe detyrimet e institucioneve përgjegjëse, të zhvilluesve, operatorëve, përdoruesve, që veprojnë në to, llojin e veprimtarive, që kryhen brenda tyre, si dhe mënyrën e përcaktimit të trojeve e të kufijve.

Neni 2
Përkufizime

(Ndryshuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik (zona)” është një territor i ndarë, sipërfaqe e përcaktuar trualli apo ndërtesash dhe pasurish të tjera të paluajtshme, e zhvilluar në përputhje me një plan të përgjithshëm dhe e pajisur me infrastrukturën e nevojshme për prodhim, zhvillim industrial, tregti dhe ofrimin e shërbimeve, që vlerësohet pjesë e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, e ndarë nga ky territor, në aspektin e regjimit fiskal dhe doganor dhe që rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji, aktet e tjera ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Termi “Zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” ka kuptimin e “zonës së lirë”, sipas Kodit Doganor.

3. “Zhvillues” është shteti ose çdo person juridik i licencuar, vendas ose i huaj, i cili ndërton, administron dhe monitoron funksionimin e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, aktet e tjera ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

4. “Përdorues” është personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, i cili ushtron veprimtari ekonomike brenda zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, aktet e tjera ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. “Infrastrukturë e përgjithshme” janë sistemet e punëve publike që përfshijnë elemente të tilla si hekurudhat, rrugët, portet, linjat e telekomunikacionit, rrjetin e energjisë, kanalizimet.

Neni 3
Krijimi i zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

¹ Në titull dhe kudo në ligj, fjalët “zonë ekonomike”, “zonë e lirë” dhe “park industrial” zëvendësohen me fjalët “zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik” *(ndryshuar me ligjin nr.54/2015)*

Krijimi i zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në Republikën e Shqipërisë synon të nxisë:

- a) investimet;
- b) hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e të ardhurave;
- c) përshpejtimin e zhvillimit rajonal dhe zgjerimin e lidhjeve ekonomike të tregut shqiptar me atë ndërkombëtar;
- ç) futjen e teknologjisë së përparuar;
- d) shpejtimin e qarkullimit të mallrave dhe të kapitaleve.

Neni 4

Shpallja e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

(Ndryshuar shkronja "b" e pikës 3, pika 5 dhe shtuar pika 6 me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

1. Në bazë të studimeve rajonale dhe të strategjisë së zhvillimit ekonomik të vendit, ministri përgjegjës për ekonominë i paraqet Këshillit të Ministrave propozimin për krijimin e një zone të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

2. Këshilli i Ministrave miraton me vendim shpalljen e një zone të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

3. Shpallja e çdo zone të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik përfshin:

a) statusin e zonës (zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik ose zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik);

b) kufijtë e zonës dhe pikat e hyrjes e të daljes;

c) llojet e veprimtarive, që do të zhvillohen në të;

ç) periudhën e funksionimit të zonës;

d) mënyrën e dhënies së zonës (qira, koncesion etj.);

dh) procedurën e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës.

4. Veprimtaria ekonomike e zonës fillon pas përfundimit të ndërtimit të kufijve rrethues, të portave të hyrjes e të daljes dhe të funksionimit të pikës doganore (në rastin e një zone të lirë).

5. Përzgjedhja e zhvilluesit të zonës bëhet sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Këshilli i Ministrave përcakton rastet dhe procedurat e ndryshimit të sipërfaqes së shtrirjes së zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 5

Veprimtaritë e lejuara në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

Në zonat e teknologjisë dhe të zhvillimit ekonomik mund të kryhet çdo lloj veprimtarie ekonomike, që nuk cenon mjedisin, florën, faunën dhe pasuritë kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

KREU II

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I ZONAVE TË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Neni 6

Institucioni përgjegjës

Ministria, e cila mbulon ekonominë, është institucioni përgjegjës që ndjek të gjitha veprimtaritë për nxitjen, identifikimin, shpalljen dhe kontrollin e mirëfunksionimit të zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 7

Lehtësitë fiskale

(Shtuar pika 8 me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Institucioni përgjegjës ka këto detyra e përgjegjësi:

1. Harton politikat dhe planet për zhvillimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.
2. Harton rregulloren e funksionimit të zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, të cilën ia paraqet për shqyrtim dhe miratim Këshillit të Ministrave.
3. Identifikon zonat potenciale dhe përgatit procedurat për shpalljen e tyre.
4. Nxit dhe asiston zhvilluesit, operatorët dhe përdoruesit për krijimin, zhvillimin dhe funksionimin e zonave.
5. Pranon dhe vlerëson kërkesat për zhvillimin e zonave.
6. Licencën zhvilluesin e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.
7. Ndjek zbatimin e ligjit, të rregullores, sipas pikës 2 të këtij neni, si dhe të kushteve të licencës nga zhvilluesit e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.
8. Miraton fillimin e veprimtarisë ekonomike të përdoruesit në zonë, duke mbajtur parasysh nxitjen e industrive të reja, teknologjive novatore, teknologjive të informacionit, industrive që përmbushin standardet ndërkombëtare të eliminimit të ndotjes, industrive eficiente në përdorimin e energjisë, si dhe industrive me produktivitet të lartë, në raport me punonjësit.

Neni 7/1

Lejet dhe licencat

(Shtuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

1. Institucionet, entet dhe autoritetet publike trajtojnë aplikimet për leje dhe licenca nga zhvilluesi ose përdoruesi, brenda 15 ditëve pune nga dorëzimi i kërkesës.
2. Për shkaqe të arsyeshme, që lidhen me kompleksitetin e licencave dhe lejeve, afati shtyhet vetëm një herë për një periudhë kohe 15 ditë pune.
3. Institucioni përgjegjës, me kërkesë të zhvilluesit ose përdoruesit, mund të aplikojë, në emër të tij, pranë institucioneve, enteve, autoriteteve publike që lëshojnë lejet ose licencat përkatëse.

Neni 7/2

(Shtuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Shteti ndërton infrastrukturën e përgjithshme deri në kufijtë e zonës.

Neni 8

Rregullorja për funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

(Ndryshuar shkronja 'c' me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Këshilli i Ministrave miraton rregulloren për funksionimin e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, e cila:

- a) përcakton procedurat e kontrollit të zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;
- b) rregullon marrëdhëniet ndërmjet institucionit përgjegjës, zhvilluesit të zonës dhe institucioneve të tjera, që ndikojnë në zhvillimin e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, duke përcaktuar detyrat e secilit prej tyre;
- c) përcakton procedurat për aplikim dhe kriteret e licencimit të zhvilluesit dhe/ose përdoruesit.

Neni 8/1

Klauzola e stabilitetit

(Shtuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

1. Institucioni përgjegjës mund të hyjë në një angazhim detyrues, në emër të shtetit, që do të ketë efektin e sigurimit të garancive të përshtatshme në favor të investitorit, me të cilin do të mbrohet kundër pasojave financiare të legjislacionit, i cili hyn në fuqi pas lëshimit të licencës ose lejes për fillimin e veprimtarisë në zonë, angazhim që u nënshtrohet kufizimeve të mëposhtme:

- a) pasojat financiare duhet të përshkruhen në mënyrë të qartë dhe të saktë;

- b) angazhimi përfundon me përfundimin e veprimtarisë në fjalë;
 - c) duhet të përshkruhet natyra e legjislacionit.
2. Një angazhim i tillë, detyruet, miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, për një periudhë 10-vjeçare, me kërkesën e autoritetit kontraktues.

KREU III MARRËDHËNIET ME ZHVILLUESIT DHE PËRDORUESIT

Neni 9

Trualli në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

Krijimi i zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik mund të bëhet në truall dhe në pasuri të tjera të paluajtshme, qofshin këto private ose shtetërore.

Neni 10

Zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në truall shtetëror

(Ndryshuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Në rastin kur trualli ose pasuritë e tjera të paluajtshme janë pronë shtetërore:

- a) kandidati zhvillues i nënshtrohet procedurës së përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b) zhvilluesi merr në përdorim truallin ose pasuritë e tjera të paluajtshme, për një periudhë kohore deri në 99 vjet dhe gëzon të drejtën e dhënies me nënqira te përdoruesit, sipas përcaktimeve të aktit nënligjor të shkronjës “a” të këtij neni.

Neni 11

Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në truall privat

1. Në rastin kur trualli ose pasuritë e tjera të paluajtshme janë pronë private, kandidati zhvillues paraqet pranë institucionit përgjegjës kërkesën për shpalljen e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, pasi ka përcaktuar marrëdhëniet me pronarin e tyre.

2. Marrëdhëniet, që lindin ndërmjet zhvilluesit dhe pronarit të truallit ose të pasurive të tjera të paluajtshme, nuk janë objekt i këtij ligji.

Neni 12

Legjislacioni i zbatueshëm

Në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

KREU IV PËRJASHTIMET NGA DETYRIMET FISKALE

Neni 13

Lehtësitë fiskale

(Ndryshuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

1. Zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik përfitojnë lehtësitë e mëposhtme:
- a) hyrja dhe dalja e mallrave në/nga zona, formalitetet dhe procedurat bëhen sipas dispozitave të Kodit Doganor;
 - b) zhvilluesit dhe përdoruesit përjashtohen nga pagesa e 50 përqindëshit të normës së tatimit për 5 vjet e para, nga fillimi i veprimtarisë së tyre në zonë;
 - c) zhvilluesit që investon në zonë, brenda 3 viteve nga data e fillimit të punimeve, ose

përdoruesit që investon në zonë, brenda 3 viteve nga fillimi i veprimtarisë ekonomike të zonës, i njihen si shpenzime të zbritshme, të periudhës tatimore, 20 për qind e shpenzimeve kapitale vjetore, pavarësisht nga shumat e amortizimit, sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, për një periudhë 2-vjeçare;

ç) furnizimi i mallrave shqiptare, të destinuara për t'u vendosur në zonë, konsiderohet si furnizim për eksport me shkallë zero, në përputhje me përcaktimet e ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe legjislacionit doganor;

d) projekti i zhvilluesit përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë;

dh) ndërtimet e realizuara në këtë zonë, sipas projektit të zhvilluesit, përjashtohen nga taksa e pasurisë së paluajtshme për një periudhë pesëvjeçare;

e) zhvilluesit ose përdoruesit e zonës janë të përjashtuar nga taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme;

ë) shpenzimet për paga dhe kontributet shoqërore e shëndetësore, që punëdhënësi paguan për punëmarrësit, njihen 150 për qind të vlerës gjatë vitit të parë fiskal të ushtrimit të aktivitetit. Në vitet në vijim, shpenzimet shtesë për pagat, në raport me vitin paraardhës, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura me 150 për qind të vlerës;

f) kostot e trajnimit të punonjësve në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, për efekt të llogaritjes së fitimit të tatueshëm, njihen si shpenzime të njohura të periudhës tatimore me dyfishin e vlerës, për një periudhë 10-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike;

g) shpenzimet për kërkim shkencor dhe zhvillim njihen si shpenzime të njohura me dyfishin e vlerës, për një periudhë 10-vjeçare nga fillimi i veprimtarisë ekonomike.

2. Transferimi i një veprimtarie ekzistuese në territorin shqiptar në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, me qëllim kryesor përfitimin e lehtësive të parashikuara në këtë ligj, është i ndaluar. Çdo transaksion, që në thelb rezulton në transferimin e veprimtarisë ekonomike, sipas përcaktimit të mësipërm, ndalohet.

3. Nëse produktet dalin nga zona për shitje në tregun e brendshëm, me një çmim nën çmimin normal për produktin në fjalë, ose produkte të ngjashme apo të zëvendësueshme në mënyrë direkte, dhe kur i shkaktohet dëm material industrisë vendase, ministria përgjegjëse për ekonominë aplikon një tarifë korrektimi të vlerës së munguar mbi produktin në fjalë. Ministria përgjegjëse për ekonominë ngarkohet për zbatimin e këtij mekanizmi korrektues.

4. Këshilli i Ministrave miraton procedurat dhe kriteret për aplikimin për përfitimin nga lehtësitë fiskale.

Neni 14

Hyrja e mallrave dhe e shërbimeve

1. Në zonat e lira hyjnë të gjitha mallrat, pavarësisht nga natyra, cilësia, origjina, prejardhja ose vendmbërritja e tyre, përveç mallrave që ndalohen nga autoritetet përkatëse të importohen, eksportohen ose tranzitohen nëpër territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Mallrat, që hyjnë në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, u nënshtrohen kontrollit doganor dhe mbikëqyrjes, në përputhje me dispozitat e Kodit Doganor dhe me rregullat për zbatimin e tij.

3. Mallrat, që sillen në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik nga një pjesë tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe që nuk janë tranzit në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, përfitojnë të gjitha lehtësitë, që përfitojnë mallrat e eksportit.

4. Kur mallrat, që kanë hyrë në një zonë të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, humbasin pa një shpjegim të arsyetuar, autoriteti doganor i zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik i kërkon subjektit të licencuar të shlyejë detyrimin për këto mallra, sipas tarifave në fuqi në kohën e hyrjes në zonë dhe gjobën e detyrueshme, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Shërbimet e infrastrukturës, që ofrohen nga pjesa tjetër e territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për zhvilluesit dhe përdoruesit e licencuar brenda zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, përfitojnë të gjitha lehtësitë, që zbatohen për eksportin e shërbimeve.

Neni 15

Dalja e mallrave dhe shërbimeve nga zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik

(Shtuar shkronja "c" e pikës, 2 me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

1. Mallrat, që dalin nga një zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, mund të jenë:
 - a) eksporte ose rieksperte, kur dalin jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë;
 - b) hyrje në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.
2. Mallrat, që hyjnë nga zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe nuk janë tranzit për në një shtet tjetër:
 - a) hidhen në qarkullim të lirë në pjesën tjetër të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet e importit. Kur këto mallra janë përfutur nga përpunimi në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, me përbërës nga tregu i brendshëm, vlera e këtyre përbërësve zbritet nga vlera e produkteve të përfutura, për përlllogaritjen e detyrimeve doganore. Taksat dhe tatimet e tjera zbatohen për vlerën e plotë;
 - b) futen në njërën nga procedurat e tjera doganore ose lloje të tjera destinacioni doganor.
 - c) produktet e transportuara nga një zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik në një tjetër, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk janë subjekt i detyrimeve doganore dhe/ose tatimore.
3. Origjina e mallrave, që dalin nga zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, përcaktohet në përputhje me Kodin Doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

Mallrat për përdorim vetjak

Mallrat për përdorim ose konsum vetjak, që hyjnë në zonën e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, u nënshtrohen të gjitha detyrimeve doganore dhe tatimore.

Neni 17

Pagesat

Pagesat, që lidhen me veprimtarinë e personave fizikë dhe juridikë, që veprojnë brenda zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, mund të kryhen me monedhën e vendit ose me monedhë të huaj.

Neni 17/1

(Shtuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Të drejtat, detyrimet dhe lehtësitë fiskale, të përcaktuara në këtë kre, aplikohen për zhvilluesin nga data e fillimit të punimeve, sipas përcaktimeve në marrëveshjen e institucionit përgjegjës me zhvilluesin.

KREU V

LICENCIMI I ZONAVE TË TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

Neni 18

Licencimi

(Ndryshuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Asnjë person nuk mund të ndërtojë, të zhvillojë, të vërë në funksionim ose të drejtojë një zonë të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik pa licencën e zhvilluesit, të lëshuar nga institucioni përgjegjës, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj, akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 19
Paraqitja e kërkesës për licencë

1. Çdo person juridik mund të paraqesë kërkesën për licencë zhvilluesi, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.
2. Çdo person fizik ose juridik mund të paraqesë kërkesën për të përsëritur licencën përkatëse, sipas procedurave të parashikuara në rregulloren e zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 20
(Ndryshuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

1. Institucioni përgjegjës i jep licencën zhvilluesit, në përputhje me procedurat e parashikuara nga ky ligj dhe aktet e tjera ligjore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
2. Institucioni përgjegjës nënshkruan marrë-veshje me zhvilluesin, në të cilën parashikohen angazhimet reciproke, afatet e realizimit, penalitetet në rast mospërbushjeje të detyrimeve, vlera, si dhe garancitë e nevojshme dhe instrumentet e sigurisë për realizimin e investimit.

Neni 21
Kushtet që i bashkëlidhen licencës

1. Institucioni përgjegjës mund t'i bashkëlidhë licencës së zhvilluesit kushte që ai i gjykon të nevojshme, të cilat kanë qenë të njohura në procesin e konkurrimit. Kushtet specifikohen në kontratë. Ato mund të ndryshohen me kërkesën e vetë zhvilluesit, kur këto nuk bien ndesh me kriteret e konkurrimit për marrjen e kësaj licence.
2. Licenca nuk tjetërsohet pa miratimin e institucionit që e lëshon.

Neni 22
Heqja ose ndryshimi i licencës
(Ndryshuar pika 3 me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

1. Ministri përgjegjës për ekonominë i heq licencën zhvilluesit kur nga institucioni përgjegjës:
 - a) konstatohet se ka pushuar së vepruari zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;
 - b) vërtetohet se i licencuari nuk respekton kushtet e licencës;
 - c) vërtetohet se i licencuari ka kryer shkelje të këtij ligji ose të rregullores së zonës së teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik;
 - ç) konstatohet se është shpallur falimentimi i të licencuarit;
 - d) vërtetohet se i licencuari nuk ka kryer detyrimet ndaj shtetit;
 - dh) konstatohet se ka mbaruar afati i licencës dhe nuk është bërë kërkesë për rinovimin e saj;
 - e) rezulton se ka kërkesë të të licencuarit.
2. Ministria përgjegjëse i njofton me shkrim të licencuarit arsyet e heqjes së licencës së zhvilluesit 30 ditë përpara heqjes së saj.
3. Mosmarrëveshjet që lindin nga heqja e licencës duhet të zgjidhen nga palët me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ato zgjidhen në rrugë gjyqësore ose nëpërmjet arbitrazhit.

Neni 22/1
Mosmarrëveshje të tjera
(Shtuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Mosmarrëveshjet midis shtetit dhe zhvilluesit ose përdoruesit zgjidhen në mënyrë gjyqësore ose nëpërmjet arbitrazhit.

Neni 23
Regjistri i licencave

Institucioni përgjegjës mban një regjistër për licencat e lëshuara për zhvilluesit, ku shënohen emri i të licencuarit, biznesi ose veprimtaria e lejuar në licencë dhe kushtet që i bashkëlidhen licencës.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24
Fitimi i tatueshëm
(Ndryshuar me ligjin nr.54/2015, datë 28.5.2015)

Fitimi i tatueshëm për periudhën tatimore përcaktohet në bazë të pasqyrave financiare, sipas ligjit për kontabilitetin, ligjit për tatimin mbi të ardhurat dhe përcaktimeve të bëra në këtë ligj. Subjektet e këtij ligji kanë të drejtë të zbatojnë standardet ndërkombëtare të kontabilitetit.

Neni 25
Përdorimi i të ardhurave

Të ardhurat, që përftohen nga dhënia e licencës dhe kontratat me subjektet e zonave të teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik, do të përdoren në përputhje me aktet nënligjore, që rregullojnë krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet shtetërore.

Neni 26
Ligji nr.9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, gjen zbatim edhe në zonat e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik.

Neni 27
Shfuqizimet

Ligji nr.8636, datë 6.7.2000 “Për zonat e lira”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 28
Zbatimi

Ngarkohen ministria përgjegjëse për ekonominë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij ligji.

Ngarkohet ministria përgjegjëse për ekonominë të përgatisë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4, 7 e 8 të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare
(shtuar me ligjin nr. 54/2015, datë 28.5.2015)

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për zonat e shpallura pas hyrjes në fuqi të tij.

Neni 29
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5444, datë 31.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

